



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 265/ 13 prot.

Datë 15/04/2025

V E N D I M
Nr. 504/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaïd Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 15/04/2025, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 447/2025, datë 07.04.2025 për procedurën e prokurimit “*Procedure e hapur mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-30047-11-19-2024, me objekt: “*Mirëmbajtje e sipërfaqeve të gjelbra dhe ujore*”, me fond limit 106,247,112 (njëqind e gjashtë milion e dyqind e dyzet e shtatë mijë e njëqind e dymbëdhjetë) lekë pa tvsh ose 1,082,276.7 (njëmilion e tetëdhjetë e dymijë e dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë pikë shtatë) Euro. Kursi i këmbimit 98.17 Lekë/Euro, kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 18.11.2024 është 98.17 Lekë/Euro, zhvilluar më datë 20.12.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.

Ankimues: Operatori ekonomik “*Malvin*” SHPK, me NIPT J76403034Q, me adresë Rruga “Jorgji Karamitri”, Shkodër.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Shkodër.
Adresa: Rruga “13 Dhjetori”, Nr.1, Shkodër.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë

13.10.2021 “Për Miratimin e Rregullave për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 07.04.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 447/2025, ku vendosi:

1. *Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Malvin” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedure e hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-30047-11-19-2024, me objekt: “Mirëmbajtje e sipërfaqeve të gjelbra dhe ujore”, me fond limit 106,247,112 (njëqind e gjashtë milion e dyqind e dyzet e shtatë mijë e njëqind e dymbëdhjetë) lekë pa tvsh ose 1,082,276.7 (një milion e tetëdhjetë e dymijë e dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë pikë shtatë) Euro. Kursi i këmbimit 98.17 Lekë/Euro, kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 18.11.2024 është 98.17 Lekë/Euro, zhvilluar më datë 20.12.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.*
2. *Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Malvin” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedure e hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-30047-11-19-2024, me objekt: “Mirëmbajtje e sipërfaqeve të gjelbra dhe ujore”, me fond limit 106,247,112 (njëqind e gjashtë milion e dyqind e dyzet e shtatë mijë e njëqind e dymbëdhjetë) lekë pa tvsh ose 1,082,276.7 (një milion e tetëdhjetë e dymijë e dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë pikë shtatë) Euro. Kursi i këmbimit 98.17 Lekë/Euro, kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 18.11.2024 është 98.17 Lekë/Euro, zhvilluar më datë 20.12.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.*
3. *Autoriteti kontraktor të rishikojë arsyet e skualifikimit për operatorin ekonomik ankimues sipas përcaktimeve në këtë vendim.*
4. *Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
5. *Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Malvin” SHPK.*
6. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
7. *Kopje e këtij vendimi, i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 7745 prot., datë 11.04.2025, protokolluar me tonën nr. 265/10 prot., datë 14.04.2025, autoriteti kontraktor Bashkia Shkodër, informon se ka zbatuar vendimin Nr. 447/2025, datë 07.04.2025, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit *“Procedure e hapur mbi kufirin e lartë monetar”*, me Nr. REF-30047-11-19-2024, me objekt: *“Mirëmbajtje e sipërfaqeve të gjelbra dhe ujore”*, me fond limit 106,247,112 (njëqind e gjashtë milion e dyqind e dyzet e shtatë mijë e njëqind e dymbëdhjetë) lekë pa tvsh ose 1,082,276.7 (një milion e tetëdhjetë e dymijë e dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë pikë shtatë) Euro. Kursi i këmbimit 98.17 Lekë/Euro, kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 18.11.2024 është 98.17 Lekë/Euro, zhvilluar më datë 20.12.2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr. 7745 prot., datë 11.04.2025, protokolluar me tonën nr. 265/10 prot., datë 14.04.2025, autoriteti kontraktor Bashkia Shkodër., informon se *“Të gjithë anëtarët e KVO-së u loguan në llogaritë personale në adresën www.app.gov.al duke përfunduar fazën e rivlersimit të ofertës në SPE të operatorit ekonomik “Malvin” SHPK duke rishikuar shkaqet e skualifikimit të këtij operatori ekonomik. Pas përfundimit të vlerësimit në SPE nga të gjithë anëtarët e KVO-së, rezulton gjëndja faktike dhe juridike e operatorit ekonomik “Malvin” SHPK edhe pas rivlerësimit ngelet e skualifikuar nga kjo procedurë prokurimi. Autoriteti Kontraktor Bashkia SHkodër, ka zbatuar me përpikmëri vendimin nr. 447/2025, datë 07.04.2025 të Komisionit Prokurimit :Publik dhe mbetet në pritje të vendimit të KPP-së për të vazhduar me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit”*. Nga sa më sipër referuar shkresës së sipërcituar, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe nga verifikimeve të kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, Komisioni vëren se, autoriteti kontraktor e ka rivlersuar procedurën e prokurimit publik objekt ankimi duke rishikuar arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “Malvin” SHPK, në përputhje me përcaktimet e bëra nga Komisioni Prokurimit Publik në vendimin nr. 447/2025, datë 07.04.2025, vendim me anë të të cilit Komisioni Prokurimit Publik ka vendosur pranimin pjesërisht të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues “Malvin” SHPK. Ndaj në këto kushte, rezulton se autoriteti kontraktor ka marrë masat e nevojshme në zbatim të përcaktimeve të bëra në vendimin KPP 447/2025, datë 07.04.2025 për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”* i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së*

Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “*Procedure e hapur mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-30047-11-19-2024, me objekt: “*Mirëmbajtje e sipërfaqeve të gjelbra dhe ujore*”, me fond limit 106,247,112 (njëqind e gjashtë milion e dyqind e dyzet e shtatë mijë e njëqind e dymbëdhjetë) lekë pa tvsh ose 1,082,276.7 (një milion e tetëdhjetë e dymijë e dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë pikë shtatë) Euro. Kursi i këmbimit 98.17 Lekë/Euro, kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 18.11.2024 është 98.17 Lekë/Euro, zhvilluar më datë 20.12.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaïd Myzyri

